EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5727
E shtunë, 16 mars 2019
çmimi 0.40 €

Edita Tahiri: Ndryshimi i kufijve rikthen armiqësitë e vjetra dhe luftërat e reja

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SMAJL LATIFI FAQE 4-5

S'ka arsye për zgjedhje të parakohshme

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Smajl Latifi, ka vlerësuar se Kosova asnjëherë nuk ka qenë më e fuqishme në aspektin politik sesa që është aktualisht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria është duke funksionuar dhe nuk ka arsye për zgjedhje të parakohshme apo për qeveri gjithëpërfshirëse. Madje, sipas Latifit, zgjedhjet parlamentare do të mbahen në vitin 2021. Duke folur për çështjen e taksës ndaj produkteve serbe, ai ka thënë se situata nuk është shqetësuese. Sipas Latifit, taksa nuk do ta rrezikojë aleancën Kosovë - ShBA. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se kryeministri Haradinaj më përpara është i gatshëm të japë dorëheqje sesa t'i dëmtojë marrëdhëniet me Amerikën. Sa i përket vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi, Latifi ka thënë se presioni ndërkombëtar duhet të përqendrohet në adresë të Serbisë

LDK-ja DHE LV-ja KËRKOJNË VLERËSIM TË KUSHTETUTSHMËRISË PËR LIGJIN E DIALOGUT

FAQE 3

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) kanë dorëzuar të premten në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Këto dy subjekte opozitare kanë kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për ta ndaluar zbatimin e këtij ligji

Sulmi terrorist në Zelandën e Re mori jetën e 49 personave

AKTUALE

VESELI PËR MARRËDHËNIET KOSOVË - JAPONI: MIQËSIA E VËRTETË NUK NJEH DISTANCA GJEOGRAFIKE F. 5

BYTYQI: ORËT E HUMBURA GJATË GREVËS DUHET TË ZËVENDËSOHEN F. 7

PËR NJË JAVË, 853 FËMIJË KËRKUAN NDIHMË MJEKËSORE F. 6

EKONOMI

MINISTRI HAMZA I OFRON PËRKRAHJE DOGANËS DHE ATK-së PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE F. 8

MEHMETI: BQK-ja PO PUNON INTENSIVISHT PËR EDUKIMIN FINANCIAR TË PUBLIKUT F. 8

KULTURË

EKREMI I PËRJETËSISË F. 11

Prof. dr. Faik SHKODRA

SPORT

DRITA KËRKON 'HAKMARRJE' NDAJ LIRISË F. 12

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht – Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Sulmi terrorist në Zelandën e Re mori jetën e 49 personave

Në sulmin terrorist të së premtes, në dy xhami në Zelandën e Re, 49 persona kanë vdekur dhe 20 të tjerë janë plagosur rëndë. Liderë botërorë kanë shprehur ngushëllimet e tyre për familjarët e viktimave dhe gjithë Zelandën e Re. Edhe liderët e Kosovës kanë dënuar ashpër këtë sulm dhe kanë shprehur ngushëllimet e tyre për familjarët e viktimave dhe gjithë Zelandën e Re

PRISHTINË, 15 MARS - Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka thënë se 49 persona kanë vdekur dhe 20 të tjerë janë plagosur rëndë si pasojë e dy sulmeve terroriste në dy xhami në qytetin Kristçërç. Ajo e ka përshkruar këtë ngjarje si sulm terrorist dhe një nga "ditët më të rënda" për këtë vend. Policia ka konfirmuar se një burrë është akuzuar për vrasje dhe do të paraqitet para gjykatës mëngjesin e së shtunës.

Autoritetet kanë ndaluar edhe dy burra të tjerë dhe një grua, afër zonës ku janë konfiskuar armët e zjarrit, ka thënë komisionari policor Mike Bush.

Për njërin prej tyre thuhet se mund të mos jetë përfshirë në incident, kurse për dy të tjerët hetimet janë ende duke vazhduar.

Një pjesë e sulmit është transmetuar drejtpërdrejt në rrjete sociale, në profilin e njërit nga sulmuesit. Në video dëgjohen tinguj të një kënge serbe, e cila madhëron 'kasapin e Bosnjës', të dënuarin për krime lufte, Radovan Karaxhiq, ka njoftuar rfe.

Policia në Zelandë të Re i ka bërë thirrje publikut që të mos i shpërndajë këto pamje "jashtëzakonisht shqetësuese".

Rrjeti social, "Facebook", ka thënë se ka bllokuar llogaritë e sulmuesit të dyshuar në "Facebook" dhe "Instagram" dhe se është duke punuar që t'i largojë të gjitha pamjet që kanë rrjedhur nga ai postim.

Kryeministri i Australisë, Scott Morrison, ka thënë se një nga të arrestuarit është qytetar australian. Ai e ka përshkruar të dyshuarin e sulmit si "terrorist të dhunshëm të ekstremit të djathtë".

I dyshuari australian besohet të ketë publikuar një manifest, në të cilin ka bërë të ditura qëllimet e tij, të bazuara në ideologji anti-imigrante dhe të ekstremit të djathtë. Dëshmitarët u kanë thënë medieve lokale se kanë vrapuar kur kanë parë njerëz që janë përgjakur jashtë xhamisë, Al Noor.

Një burrë ka thënë të ketë qenë në xhaminë Al Noor dhe ka përshkruar sulmuesin si njeri të bardhë, që ka pasur të veshur një jelek antiplumb. Ai ka thënë se ky person ka nisur sulmin në xhami, derisa besimtarët kanë qenë duke u lutur. "Ai ka pasur armë të madhe, ka hyrë dhe ka nisur sulmin ndaj secilit në xhami, gjithandej", ka thënë Ahmad Al-Mahmoud. Ai ka thënë se bashkë me shumë persona të tjerë kanë ikur përmes një xhami të thyer.

Një xhami e dytë në lagjen Lajnvud është evakuuar derisa komisionari Bush ka thënë se dhjetëra viktima janë raportuar në të dyja vendet.

Autoritetet kanë këshilluar mbylljen e të gjitha xhamive deri në njoftimin e radhës, duke thënë se ngjarja e së premtes ka qenë e pashembullt.

Kryeministri australian Scott Morrison ka kërkuar që në shenjë respekti për të gjithë të vrarët, flamujt të vendosen në gjysmështizë.

Pas lajmit për sulme terroriste, liderë botërorë kanë shprehur ngushëllimet e tyre për familjarët e viktimave dhe gjithë Zelandën e Re.

Kryeministrja britanike, Theresa May, ka thënë se "është bashkë me gjithë të prekurit e këtij sulmi". Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, e ka cilësuar këtë sulm "brutal" dhe ka thënë se as ky incident nuk do ta "zvogëlojë kurrë tolerancën për të cilën njihet Zelanda e Re".

Presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, u ka bërë thirrje vendeve perëndimore që të marrin masa për të zvogëluar rritjen e racizmit kundër islamit dhe myslimanëve pasi, sipas tij, sulmet sikurse ky në Zelandën e Re, mund të jenë më pas të "pashmangshme".

Kryeministri pakistanez Imran Khan ka fajësuar atë që e ka cilësuar si islamofobi në rritje për incidentin në Zelandën e Re. Përmes një postimi në "Twitter", ai ka thënë se "terrorizmi nuk ka fe".

Ministria e Jashtme e Kosovës ka konfirmuar se asnjë kosovar nuk është prekur nga ky sulm terrorist.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se "Republika e Kosovës e dënon ashpër aktin terrorist" në Zelandën e Re.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, u ka shprehur ngushëllime familjarëve dhe institucioneve të Zelandës së Re.

"Terrorizmi, pa marrë parasysh nga kush vjen, është e keqja më madhore me të cilën duhet të përballemi të gjithë së bashku. Kosova do të vazhdojë ta japë kontributin e saj përkrah aleatëve strategjikë për sigurinë globale", është shprehur Haradinaj.

ShBA-ja i kërkoi opozitës të mos ketë dhunë, përgjigjet Basha

TIRANË, 15 MARS - Duke u përgjigjur në pyetjen se Ambasada Amerikane i ka kërkuar të premten opozitës që të lejojë pjesën tjetër të deputetëve të punojnë dhe të mos ketë akte dhune, Basha tha se ndërkombëtarët duhet të jenë palë për vlerat e demokracisë, të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të luftës kundër korrupsionit, të luftës kundër krimit të organizuar dhe drogës, të luftës kundër shitblerjes së votës. "Asnjëherë nuk komentoj deklaratat e ambasadave, por meqenëse më pyesni, e kam një sugjerim. Nuk i kërkoj të jenë palë me asnjë person në Shqipëri, me asnjë parti politike, por u kërkoj të jenë palë për vlerat me të cilat vendet e tyre qëndrojnë, vlerat e demokracisë, të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të luftës kundër korrupsionit, të luftës kundër krimit të organizuar dhe drogës, të luftës kundër shitblerjes së votës. Probleme të cilat i shprehu qartë edhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit para ditësh.

Protesta e së shtunës do të jetë një tjetër rast për shqiptarët, për t'u bashkuar dhe për ta ngritur zërin. Shqiptarët tashmë e kanë kuptuar se e vetmja mënyrë për të garantuar ndarjen e së keqes është protesta. Këtë e tregoi protesta e Teatrit, këtë e tregoi protesta e banorëve të Unazës, këtë e tregoi protesta e studentëve, këtë e tregoi protesta e 16 shkurtit dhe protestat e tjera që pasuan. Këtë do ta tregojë edhe protesta e së nesërmes, për të cilën kam bindjen dhe informacionin se do të hyjë në histori si një nga protestat më të të mëdha, një nga bashkimet më të mëdha të

qytetarëve, për të ndalur të keqen dhe për të hapur derën e mbyllur të Evropës", tha Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) e kanë dorëzuar
në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për dialogun

LDK-ja dhe LV-ja kërkojnë vlerësim të kushtetutshmërisë për Ligjin e dialogut

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) kanë dorëzuar të premten në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Këto dy subjekte opozitare kanë kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për ta ndaluar zbatimin e këtij ligji

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 MARS - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) e kanë proceduar të premten në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovë në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Në konferencën për medie, deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, dhe deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu, kanë treguar se këtë ligj e kanë dorëzuar në Kushtetuese për shkak të shkeljeve, në të paktën tetë nene të Kushtetutës së vendit. Ata kanë kërkuar vendosjen e masës së përkohshme për ta ndaluar instalimin e këtij precedenti të rrezikshëm dhe kërkojnë një seancë dëgjimore për t'i argumentuar çështjet e ngritura prej tyre. "Deputetët e LDK-së, në bashkëpunim të ngushtë me deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, vendosën ta procedojnë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Ne e kontestojmë në tërësi këtë ligj, sepse po vlerësojmë se një ligj i tillë është në kundërshtim me shumë nene të Kushtetutës", ka thënë deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, duke përmendur nenet e Kushtetutës me të cilat, sipas tij, bie në kundërshti ligji në fjalë. "Fillimisht shkel nenin dy të Kushtetutës, nenin 4 të Kushtetutës ku flet për formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve, nenin 7 të Kushtetutës ku flet për rendin kushtetues, nenin 18 të Kushtetues ku flet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, nenin 20 të Kushtetutës ku flet për bartjen e sovranitetit dhe kalimin e kompetencave shtetërore, nenin 65 të Kushtetutës ku flet për kompetencat e Kuvendit, nenin 93 të Kushtetutës ku flet për kompetencat e Qeverisë dhe nenin 94 të Kushtetutës ku flet për kompetencat e kryeministrit", ka thënë Selmanaj. Sipas tij, aspekti përmbajtjesor, ku këto dy subjekte politike kontestojnë këtë dokument, koncentrohet në tri shtylla kryesore. "Shtylla e parë ka të bëjë me tendencat që përmes këtij ligji të përcaktohet ndryshimi i hierarkisë institucionale dhe kushtetuese dhe vendimmarrjes në dialogun me Serbinë. Shtylla e dytë ka të bëjë me kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror, në fakt e kemi parë si tendencë të drejtpërdrejtë të ndërhyrjes në kompetenca kushtetuese të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. E treta ka të bëjë me përpjekjet për t'i dhënë këtij ligji karakter leg specialis", ka thënë Selmanaj.

Ai ka shprehur optimizëm se kërkesa e tyre do të pranohet nga Kushtetuesja. "Si grupe parlamentare dhe si deputetë të dy partive politike kontestojmë në tërësi kushtetutshmërinë e këtij ligji. Besojmë se përgjigjja do të jetë edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese, që ky ligj të rrëzohet dhe, si i tillë, mandati kushtetues i institucioneve të mos cenohet", ka thënë Selmanaj.

Kurse deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu, ka thënë se kanë kërkuar që të vendosë menjëherë masë të përkohshme për ta ndaluar ekipin e dialogut të marrë ndonjë veprim karshi dialogut me Serbinë. Sipas saj, përmes këtij ligji po synohet të shkelet Kushtetuta vetëm për t'i shërbyer projektit për ndarjen e Kosovës. "Gjithë kjo aventurë e fundit është në shërbim të plotë të Hashim Thaçit. Në këtë kaos të qëllimshëm që po krijojnë aktorët që ishte dashur ta ruajnë koherencën e politikës së jashtme dhe sovranitetin e integritetit territorial, përfshihet edhe i ashtuquajtur ligj për dialogun", ka thënë Haxhiu.

Deputetët e dy subjekteve opozitare deklaruan se veprimet e tyre nuk do të kufizohen këtu. Në rastin e shpenzimit të të gjitha mjeteve juridike për kundërshtimin e këtij ligji, ata kanë deklaruar se do të vazhdojnë shfrytëzimin e të drejtës për të protestuar kundër një procesi kaq të rrezikshëm.

LDK-ja nga java e ardhshme fillon përgatitjet për zgjedhjet e brendshme në parti

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka mbajtur të premten mbledhje të kryesuar nga kryetari Isa Mustafa. Sipas një njoftimi të LDK-së, gjatë kësaj mbledhje është diskutuar për organizimin e zgjedhjeve në LDK, mbi platformën e aprovuar nga Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së në nëntor të vitit 2018. Në këtë mbledhje është aprovuar struktura e pjesëmarrjes së delegatëve të degëve për Kuvendin e LDK-së. "Po ashtu, kryesia është pajtuar që nga java e ardhshme, bashkë me kryetarët aktualë të degëve, të fillojnë përgatitjet administrative dhe teknike për realizimin e këtyre zgjedhjeve", është thënë në njoftimin e LDK-së.

Flet për "Epokën e re", Smajl Latifi

S'ka arsye për zgjedhje të pa

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Smajl Latifi, ka vlerësuar se Kosova asnjëherë nuk ka qenë më e fuqishme në aspektin politik sesa që është aktualisht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria është duke funksionuar dhe nuk ka arsye për zgjedhje të parakohshme apo për qeveri gjithëpërfshirëse. Madje, sipas Latifit, zgjedhjet parlamentare do të mbahen në vitin 2021. Duke folur për çështjen e taksës ndaj produkteve serbe, ai ka thënë se situata nuk është shqetësuese. Sipas Latifit, taksa nuk do ta rrezikojë aleancën Kosovë - ShBA. Në këtë kontekst, ai ka theksuar se kryeministri Haradinaj më përpara është i gatshëm të japë dorëheqje sesa t'i dëmtojë marrëdhëniet me Amerikën. Sa i përket vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi, Latifi ka thënë se presioni ndërkombëtar duhet të përqendrohet në adresë të Serbisë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 15 MARS -

"Epoka e re": *Z. Latifi, gjatë kësaj jave Kosova është vizituar nga zyrtarë të lartë gjermanë dhe britanikë të cilët kanë kërkuar pezullimin e taksës. Pas thirrjeve të partnerëve ndërkombëtarë, ka reflektim të kryeministrit për të lëvizur përpara në këtë proces?*

Latifi: Në fakt, presioni duhet të përqendrohet në adresë të Serbisë. Bashkësia ndërkombëtare e di që problemi është Serbia dhe jo Kosova. Të gjithë ata që mendojnë se është mirë të ecet rrugës së normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi për arritjen e një marrëveshje që ka për qëllim njohjen reciproke atëherë presioni duhet të drejtohet te Serbia, e cila është shkaktare e shumë të këqijave në Kosovë. Pra, si pasojë e veprimeve agresive të saj kundër Kosovës, është vendosur taksa. Tekefundit, presioni në adresë të Serbisë është rruga më e qartë dhe më e duhur për ta bërë të gjithë, edhe ne si Kosovë, edhe bashkësia ndërkombëtare, sepse problem është Serbia, jo Kosova.

"Epoka e re": *Si pasojë e kësaj takse Kosova po rrezikon partneritetin me ShBA-në.*

Latifi: Raportet ShBA - Kosovë nuk rrezikohen në qoftë se ka dallime në vlerësimin e situatës për sa i takon taksës. Marrëdhëniet Kosovë - ShBA po kultivohen gjithnjë e më shumë. Prandaj nuk është e vërtetë se po rrezikohen raportet me ShBA-në. Kjo çështje më shumë po interpretohet nga disa qarqe dhe individë. E ka thënë edhe kryeministri se nuk është i gatshëm që në emër të Qeverisë së Kosovës ta ndjekë rrugën e dëmtimit apo prishjes së marrëdhënieve Kosovë - ShBA.

"Epoka e re": *Pra, në momentin që këto marrëdhënie vihen në pikëpyetje, kryeministri do të tërhiqet?*

Latifi: Ai ka deklaruar se më përpara do të shkojë në shtëpi sesa që do ta rrezikojë aleancën Kosovë - ShBA. Nuk është për t'u shqetësuar, sepse taksa është vendosur ndaj Serbisë dhe jo ndaj të tjerëve. Ndërkaq në shumë relacione po funksionojnë përditë e më mirë raportet Kosovë - ShBA. Kurse përderisa Serbia nuk ka gatishmëri për të reflektuar dhe korrigjuar vetveten, është i pakuptimit presioni apo kushtëzimi që po tenton ta bëjë në drejtim të rivendosjes së dialogut.

"Epoka e re": *Mund të ketë vazhdim të dialogut pa u pezulluar taksa?*

Latifi: Nëse Serbisë i ngutet le të ulet në tavolinën e bisedimeve dhe Kosova nga këto bisedime kërkon njohjen reciproke dhe normalizimin e marrëdhënieve. Prandaj, në momentin kur të qartësohet pozicioni i Kosovës dhe i Serbisë, si dhe kur të dihet saktësisht se procesi po shkon drejt përfundimit, atëherë në kuadër të kësaj mund të shihet edhe marrëveshja e Kosovës me Serbinë për tregtinë e lirë, që nënkupton pezullimin ose heqjen e taksës. Serbia duhet ta njohë realitetin se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Për këtë qëllim jemi duke punuar edhe ne.

"Epoka e re": *Çështja e taksës, a mund të jetë arsye për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj?*

Latifi: Në qoftë se Qeveria e Kosovës po u dashka të rrëzohet

rakohshme

për shkak se ka vendosur taksë ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjës atëherë lë të rrëzohet. Për sa kohë që situata është kështu dhe Serbia nuk ndryshon qasje, Kosova është në pozitë shumë të fortë. Kushdo prej forcave politike që e merr përsipër rrëzimin e Qeverisë në këtë situatë atëherë duhet ta mendojë nëse duhet apo jo të konkurrojë në zgjedhjet sepse do të pësojë rënie rapide meqë populli i Kosovës ka vuajtur shumë prej veprimeve agresive të Serbisë. Edhe pse Kosova është bërë shtet, Serbia vazhdon të ketë qasje armiqësore dhe agresive ndaj Kosovës, dhe populli i Kosovës e di mirë këtë. Ata që tentojnë ta rrëzojnë Qeverinë në këtë situatë, duhet ta kenë parasysh edhe çmimin që do ta paguajnë në zgjedhje. Qeveria edhe mund të bjerë, por taksa mbetet. Qeveria po funksionin, por natyrisht se nuk është e lehtë asnjë punë sikurse nuk është as situata në raport me taksën ndaj Serbisë. Pavarësisht prej kësaj, Qeveria është duke funksionuar dhe jam i bindur se zgjedhjet do të mbahen në vitin 2021.

"Epoka e re": *Si mund ta çoni deri në fund mandatin kur Qeveria në vazhdimësi po ballafaqohet me probleme?*
Latifi: Qeveria është aktive dhe po punon. Është e drejtë e secilit të kritikojë apo të japë vërejtje. Kosova nuk ka komoditet për të shkuar në zgjedhje sepse po ndodhin zhvillime të rëndësishme. Qeveria Haradinaj ka kryer shumë punë dhe ka marrë vendime të rëndësishme, por natyrisht se ka edhe të meta në qeverisje. Ka bërë shumë punë edhe në nivelin lokal duke iu përgjigjur kërkesave të komunave. Kosova e ka ushtrinë, Ligjin për paga, Ligjin për kryeqytetin etj. Ka plot veprime qeverisëse të cilat e kanë rikthyer Kosovën në rrugën e duhur. Natyrisht jemi të vetëdijshëm se ka probleme dhe sfida që duhet t'u japim zgjidhje.

"Epoka e re": *Këto ditë është folur edhe për mundësinë e krijimit të një qeverie gjithëpërfshirëse. Do të pranonte AAK-ja të jetë pjesë e saj?*
Latifi: Qeveria Haradinaj është funksionale dhe stabile. Nëse është çështja te dialogu, për herë të parë kemi ligjin dhe platformën për këtë proces. Kontributin e tyre në këtë proces mund ta japë edhe opozita, por nuk mund të ketë qeveri gjithëpërfshirëse apo zgjedhje të parakohshme pse kërkojnë partitë opozitare. Qeveria po funksionon dhe nuk ka arsye për qeveri gjithëpërfshirëse apo zgjedhje të parakohshme.

"Epoka e re": *Ka unitet brenda koalicionit për ta vazhduar qeverisjen?*
Latifi: Problemi nuk është këtu, sepse kjo diskutohet nga partnerët e koalicionit, por po flasim për institucione funksionale. Dhe një prej institucioneve më të rëndësishme siç është Qeveria po funksionon dhe nuk ka arsye për të çuar vendin në zgjedhje. Kurdo që Serbia është e gatshme ta pranojë ofertën e Kosovës për njohjen reciproke ne jemi këtu. Në këta 20 vjet Kosova asnjëherë nuk ka qenë më e fuqishme në aspektin politik sesa që është tash.

Veseli për marrëdhëniet Kosovë - Japoni: Miqësia e vërtetë nuk njeh distanca gjeografike

Tokio, 15 mars (ER) - Në traditën e popullit tim ekziston një shprehje e vjetër, por gjithmonë aktuale: miku i mirë njihet në ditë të vështira. Dhe ishin pikërisht ditët më të vështira për popullin tonë, kur ai ndjeu dorën e solidaritetit japonez, shpirtgjerësinë e tij, humanizmin e tij. Kështu ka thënë kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në pritjen e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Tokio të Japonisë, ku ishin të pranishëm mbi 200 pjesëmarrës, zyrtarë të lartë shtetit japonez, përfaqësues të korit diplomatik të akredituar në Tokio si dhe artistë.
Para të pranishmëve, kryeparlementari Veseli ka thënë se muajin që shkoi Kosova festoi 11-vjetorin e pavarësisë dhe, sipas tij, të njëjtën moshë kanë edhe marrëdhëniet e saj me Japoninë, ngase Japonia ishte ndër vendet e para që njohu Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.
Kreu i Kuvendit tha se marrëdhëniet mes dy vendeve janë shembulli më i mirë që tregon se miqësia e vërtetë nuk njeh distanca gjeografike, as barriera humane. "Njerëzit tuaj nuk e pranuan indiferencën, kapërcyen distancat e mëdha njerëzore e gjeografike, të cilat qëndrojnë mes dy vendeve tona, dhe na u gjetën pranë kur ne kishim nevojë jetike për përkrahje. Prandaj, kam nderin dhe privilegjin që sonte, në këtë ambient kaq miqësor, në emër të popullit të Kosovës, ta falënderoj popullin dhe qeverinë japoneze për mbështetjen e madhe që na kanë dhënë tash e dy dekada. Ne nuk do ta harrojmë kurrë përkrahjen tuaj. Sot fëmijët tanë rriten me ndjenjën e respektit për vendin tuaj dhe sa e sa vende të tjera. Ne kemi një emër të përbashkët për ju dhe këto vende. Ne ju quajmë miqtë e lirisë sonë", ka thënë Veseli.
Në vazhdim të fjalës së tij, kryeparlamentari Veseli ka thënë se vizita e tij në Japoni ka për qëllim të ndihmojë në thellimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve. Ai ka theksuar se në vitin e ardhshëm pritet ta fillojë punën Ambasada e Japonisë në Prishtinë dhe qytetarët e Kosovës mezi presin ta shohin flamurin e Japonisë duke u valëvitur në qiellin e Prishtinës. "Ne duam të kemi prani japoneze në të gjitha fushat e jetës. Ju jeni një komb i madh, prej të cilit ne duam t'i mësojmë vlerat shembullore, etikën e punës dhe shpirtin sipërmarrës, gjithë shembullin e një shoqërie që, mbi gërmadhat e luftës, ndërtoi një model suksesi, frymëzues për të gjithë botën", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

KDI-ja: Gratë në zona rurale kanë pengesa bazike për pjesëmarrje në jetën publike

Qendresa RAMA

Prishtinë, 15 mars - Gratë vazhdojnë të përballen me probleme elementare që kushtëzojnë pjesëmarrjen e tyre të barabartë në tregun e punës dhe jetën publike. Veçanërisht ato që jetojnë në fshatra përballen me mungesë të shërbimeve bazike shëndetësore, mungesë të çerdheve të cilat ua rëndojnë përditshmërinë dhe i pengojnë për të qenë aktive në treg të punës apo për t'u angazhuar në çështje publike. Pikërisht me këto probleme përballen edhe gratë e fshatrave Milloshevë dhe Lajthishtë të Komunës së Obiliqit, të cilat gjatë dy takimeve të ndara të organizuara nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me përfaqësues komunalë, kërkuan zgjidhjen e tyre dhe avancim të pozitës së gruas në këtë rajon.

Duke qenë se në këtë komunë funksionon vetëm Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, e ndërtuar së voni në Milloshevë, nuk po i përmbush nevojat dhe kërkesat që kanë qytetarët andaj, gratë e pranishme në këto takime e konsideruan si të nevojshme zgjatjen e orarit të punës së kësaj qendre.

Njëjtë është situata edhe me praninë e gjinekologut në këtë komunë. Edhe pse orari i punës së gjinekologut është tetë orë në ditë, prania e tij/saj në qendër është vetëm tri orë dhe për shërbime të tjera jashtë këtij orari gratë duhet t'i drejtohen Prishtinës.

Mungesa e çerdhes është një tjetër sfidë që gratë në këtë komunë e vlerësojnë si mjet që do t'ua lehtësonte punësimin dhe avancimin e tyre. Meqenëse në Komunën e Obiliqit është vetëm një çerdhe publike, ndërtimi i një çerdheje të re ose ngritja e kapaciteteve për pranimin e më shumë fëmijëve, në çerdhen ekzistuese do të kontribuonte shumë për mirëqenien e grave në tërësi, por edhe të fëmijëve në veçanti, konsideruan të pranishmet në këto takime.

Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë për Financa në Komunën e Obiliqit, Zarife Behluli, që ishte në takime, shpalosi planet komunale që përfshijnë përfundimin e infrastrukturës në këtë komunë gjatë vitit 2019. Sipas saj, do të ketë hapësirë edhe për investime që ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve në tërësi, të grave në veçanti, duke i siguruar ato për mbështetje në aktivitete dhe për ngritje të kapaciteteve në punësim.

Nisin punimet për rrugën Gjakovë - Dollc

Gjakovë, 15 mars (ER) - Kanë nisur të premten punimet për zgjerimin e rrugës Gjakovë - Dollc, një projekt ky i financuar në tërësi nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës. Në ceremoninë e nisjes së punimeve ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, dhe ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, Pal Lekaj. Me këtë rast, kryetari Gjini ka thënë se ky është një prej projekteve më të mëdha që po ndodhin në Komunën e Gjakovës në 30 vjetët e fundit, ndërsa ka shprehur bindjen e tij se me qeverisjen Haradinaj do të ndodhin edhe shumë projekte të tjera të cilat Komunën e Gjakovës do ta nxjerrin në një kapitull të ri. Kryetari Gjini ka shtuar se me qeverisjen Haradinaj ky vit do të jetë vit i jashtëzakonshëm për Komunën e Gjakovës, Dukagjinin dhe tërë Kosovën.

Ndërsa ministri Pal Lekaj në fjalën e tij ka thënë se me këto investime po dëshmohet se Qeveria Haradinaj është një qeveri që e mbanë fjalën dhe një qeveri që është e vendosur që me këto investime ta bëjë këtë anë më atraktive për investimet e huaja. Rruga Gjakovë - Dollc që e lidhë Gjakovën me Prishtinën është e gjatë rreth 31 kilometra, me një vlerë investimi rreth 57 milionë euro.

Qalaj dhe Matoshi pajtohen për aktivitete të përbashkëta për ruajtjen e mjedisit

Prishtinë, 15 mars (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka pritur të premten në takim ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshin, të cilin e ka njoftuar për përkushtimin e policisë për realizimin e detyrave dhe obligimeve të saj ligjore karshi qytetarëve, në të mirë të sigurisë dhe rendit publik. Në këtë takim, ku i pranishëm ka qenë edhe sekretari i përgjithshëm i MMPH-së, Arben Çitaku, Qalaj dhe Matoshi kanë diskutuar për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve përmes planeve të përbashkëta, të cilat do të ndikojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit. "Takimi rezultoi me gatishmërinë për avancim të bashkëpunimit të ndërsjellë drejt ndërmarrjes së veprimeve konkrete për mbrojtjen e mjedisit dhe për parandalimin e rasteve të ndotjes, pasi mbrojtja e mjedisit përbën një kusht themelor të zhvillimit të shoqërisë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Për një javë, 853 fëmijë kërkuan ndihmë mjekësore

Prishtinë, 15 mars (ER) - Emergjenca Pediatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) për një javë ka pasur 853 fëmijë që kanë kërkuar ndihmë mjekësore si pasojë e shqetësimeve të ndryshme shëndetësore. Sipas raportit javor të Klinikës së Pediatrisë, për një javë në ambulancat specialistike ka pasur 538 vizita mjekësore të fëmijëve. Po ashtu, Klinika e Pediatrisë ka qenë e mbingarkuar me rastet e pranimeve për hospitalizim të mëtejmë, ku vetëm për një javë ka pasur 154 pranime.

Edita Tahiri: Ndryshimi i kufijve rikthen armiqësitë e vjetra dhe luftërat e reja

Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, në një takim në Nju Jork me ambasadoren amerikane në OKB, Cherith Chalet, ka biseduar për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe rajon. Tahiri ka theksuar se Kosova është kategorikisht kundër ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Nju Jork, 15 mars - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, në cilësinë e kryetares së Lobit Rajonal të Grave të Evropës Juglindore, po qëndron në një vizitë pune në Nju Jork, ShBA, me ftesë të UNWomen, për të marrë pjesë në aktivitetet që lidhen me Sesionin e 63-të të Komisionit të OKB-së për statusin e grave. Gjatë këtij qëndrimi, që përfshinë një varg aktivitetesh, ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, u takua me ambasadoren amerikane në OKB, Cherith Chalet, me të cilën ka biseduar për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe rajon. Ajo me këtë rast ka falënderuar ShBA-në për gjithë mbështetjen që i ka dhënë Kosovës në proceset e lirisë dhe të pavarësisë, duke thënë se populli i Kosovës do të jetë çdoherë mirënjohës për këtë mbështetje.

Tahiri ka theksuar se ShBA-ja ka hyrë në historinë e lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës si aleatja kryesore dhe strategjike. Duke folur për zhvillimet në Kosovë dhe rajon, Edita Tahiri ka theksuar se në këtë kohë, në vend se të ketë përparime, janë shfaqur ide të rrezikshme për prekje kufijsh, të cilat mund ta kthejnë rajonin prapa, duke rikthyer armiqësitë e vjetra dhe luftërat e reja. Ajo ka thënë se Kosova është kategorikisht kundër ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "I gjithë spektri politik dhe institucional është kundër. Jemi kundër ne themeluesit e këtij shteti, në mesin e të cilëve jam unë personalisht. Pavarësisht se presidenti i Kosovës, z. Thaçi, është angazhuar rreth kësaj ideje të rrezikshme, ai është i vetmuar në këtë çështje dhe nuk gëzon përkrahje", ka thënë Tahiri.

Edita Tahiri ka theksuar se ideja e ndryshimit të kufijve dëmton shtetësinë dhe territorin e



Kosovës e cila u fitua pas një lufte dhe sakrifica të shqiptarëve përgjatë një shekulli. Ajo ka theksuar se mbështetja amerikane dhe aleatëve perëndimorë ishte vendimtare për ta krijuar shtetin e Kosovës e cila tashmë është e njohur ndërkombëtarisht nga Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi dhe kufijtë e saj janë njohur ndërkombëtarisht.

Ish-ministrja Tahiri ka kërkuar nga ShBA-ja që të mbështesë Kosovën dhe kufijtë e saj, ndërsa ka kërkuar të ndalen Rusia dhe Serbia në ambiciet e tyre gjeopolitike për ta rikthyer dominimin në Ballkan përmes ideve të tilla hegjemoniste. "Vendet e Ballkanit, përfshirë Kosovën, janë përcaktuar për drejtimin gjeopolitik perëndimor dhe ardhmërinë euroatlantike", ka thënë ajo.

Ndërsa ambasadorja amerikane Cherith Chalet ka shprehur kënaqësinë për takimin dhe ka mirëpritur bisedat dhe analizat për zhvillimet më të reja në Kosovë dhe rajon. Ajo ka theksuar se ShBA-ja mbështet shtetin e Kosovës në rrugën e saj euroatlantike dhe i gëzohet çdo progresi në Kosovë dhe për popullin e Kosovës.

Ambasadorja Chalet, po ashtu, ka thënë se do ta njoftojë qeverinë amerikane rreth përmbajtjes së bisedave të këtij takimi.

Bytyqi: Orët e humbura gjatë grevës duhet të zëvendësohen

Prishtinë, 15 mars (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka përsëritur të premten para Komisionit Parlamentar për Arsim qëndrimin e tij se, vendimi për orët e humbura gjatë grevës në arsim duhet të zbatohet i plotë në mënyrë që të mos humbin nxënësit.

Në mbledhjen, e cila është mbajtur me ftesë të Komisionit Parlamentar për Arsim, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBAShK-ut, pas diskutimeve të shumta, ministri Bytyqi është pajtuar me propozimin e komisionit që edhe këtë të shtunë të mos ketë zëvendësim të orëve të humbura, por kjo të fillojë nga e shtuna e ardhshme. Për këtë, MAShT-i do t'i njoftojë edhe zyrtarisht drejtoritë komunale të arsimit.

Komisioni Parlamentar për Arsim e ka vlerësuar planin e Ministrisë për zëvendësimin e orëve të humbura, ndërsa ky propozim është bërë për t'i dhënë kohë Sindikatës që të reflektojë pozitivisht dhe mësimi të fillojë të zëvendësohet nga e shtuna e ardhshme. Megjithatë, në këtë mbledhje ministri Bytyqi ka përmendur disponimin e drejtorive komunale të arsimit që të fillojë zbatimi i vendimit për kompensimin e orëve të humbura, ndërsa ka paralajmëruar masa ligjore ndaj të gjithë individëve që do të përpiqen ta pengojnë zbatimin e vendimit.

Energjia, shtyllë e rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

PRISHTINË, 15 MARS (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të premten në takim përfaqësuesit e Ambasadës Gjermane në Kosovë, drejtorin e KfW-së, Rene Eschemann, kryeshefin e KOSTT-it, Ilir Shala, dhe kryetarin e Bordit të ZRrE-së, Arsim Janova, me të cilët ka biseduar për zhvillimet në sektorin e energjisë, për stabilitetin e energjisë elektrike në vend, për kyçjen e burimeve të ripërtërishme, për përmirësimet në rrjet dhe për partneritetin me institucionet ndërkombëtare në këtë fushë.

Në takim, ku ishin të pranishëm edhe ministrat Endrit Shala dhe Valdrin Lluka, kryeministri Haradinaj ka falënderuar përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe të Ambasadës së Gjermanisë për kontributin e tyre në fusha të ndryshme, veçmas në sektorin e energjisë.

Duke vlerësuar rëndësinë e energjisë, Haradinaj ka thënë se energjia është shtyllë e rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, parakusht i rritjes së investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme, si dhe parakusht i mirëqenies së qytetarëve.

Haradinaj është njoftuar nga përfaqësuesit e ZRrE-së dhe KOSTT-it me punët dhe sfidat në dikasteret e tyre përkatëse, furnizimin e rregullt me energji si dhe koston e energjisë. Po ashtu, në takim është theksuar nevoja që Kosova të ketë një qasje më proaktive për ta përmirësuar pozitën e saj sa iu përket institucioneve ndërkombëtare të sektorit të energjisë, si një nga fushat jetike të mirëqenies së qytetarëve.

Ndërsa përfaqësuesit e KfW-së, të Ambasadës së Gjermanisë, kanë theksuar mbështetjen për Kosovën në fusha të ndryshme edhe në sektorin e energjisë.

Ministri Hamza i ofron përkrahje Doganës dhe ATK-së për realizimin e objektivave

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MARS - Ministri i Financave, Bedri Hamza, të premten ka vizituar Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, ku është njohur me punën e këtyre dy institucioneve.

Ministri Hamza, në takim me drejtorin e Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka diskutuar për çështje të ndryshme të Doganës. Hamza ka falënderuar stafin e Doganës për kontributin e dhënë për sigurimin e të hyrave dhe rritjen e tyre. Gjithashtu, ka kërkuar përgjegjësi për zbatimin ligjit dhe për mbledhjen e të hyrave shumë të domosdoshme për buxhetin e Kosovës.

Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe çështje të ndryshme që ndërlidhen me proceset e punës dhe sfidat me të cilat përballet Dogana gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Po ashtu, ministri Hamza është takuar edhe me drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, me të cilin ka folur rreth aktiviteteve të cilat pritet të zhvillohen në këtë institucion.

Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, fillimisht e ka njoftuar ministrin Hamza për prioritet e Administratës Tatimore për këtë vit si dhe për aktivitet e tjera të cilat tani janë të vendosura edhe në planin e punës për vitin 2019.

Ndër të tjera, gjatë takimit me ministrin, drejtori Murtezaj ka thënë se këtë vit do të punojnë shumë për automatizimin e shërbimeve për tatimpaguesit në rimbursimin e TVSh-së, të kontrolleve dhe mbledhjes së detyrueshme, me qëllimin e vetëm të krijimit të lehtësirave për përmbushjen e deklarimeve tatimore, si dhe të rritjes së transparencës ndaj tatimpaguesve.

Ndërkaq ministri i Financave, Bedri Hamza, ka përgëzuar drejtorin për pozitën e re, duke potencuar se mbështetja e tij do të jetë e fuqishme, në të gjitha kërkesat që lidhen me arritjen e objektivave të ATK-së. Po ashtu, ministri Hamza ka vlerësuar lart rolin e ATK-së, duke theksuar se suksesi i ATK-së është sukses i shtetit të Kosovës.

Gjatë këtij takimi u tha se ATK-ja do të punojë me përkushtim të plotë dhe me profesionalizëm që ta arrijë suksesshëm mbledhjen e të hyrave të pritshme qeveritare, në mënyrë që të sigurohet stabilitet financiar për vendin. Sipas përfaqësueseve të ATK-së, fokusi i tyre mbetet rritja e nivelit të përmbushjes vullnetare të tatimpaguesve sipas legjislacionit tatimor të Kosovës.

BQK-ja shënoi Ditën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Drejtave të Konsumatorit

Mehmeti: BQK-ja po punon për edukimin financiar të publikut

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se falë marrjes së masave nga ky institucion gjatë këtyre 20 vjetëve, vendi ka një sistem financiar modern dhe të shëndoshë, i cili me shumë sukses po realizon rolin e ndërmjetësimit financiar në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 MARS - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 20-vjetorit të themelimit, ka mbajtur diskutim për nder të Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Konsumatorit, me temë "Roli i BQK-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit". Me këtë rast, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se falë marrjes së masave nga BQK-ja gjatë këtyre 20 vjetëve, vendi ka një sistem financiar modern dhe të shëndoshë, i cili me shumë sukses po realizon rolin e ndërmjetësimit financiar në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit.

Vend të rëndësishëm, sipas guvernatorit Mehmeti, kanë zënë aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare, duke u fokusuar në dy shtyllat kryesore të mbrojtjes së konsumatorit: shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve dhe edukimin financiar. "Përderisa në vitet e para të funksionimit të sistemit financiar fokusi ishte në krijimin e kushteve për sigurimin e shërbimeve financiare bazike për ekonominë e vendit, tani kemi arritur në një fazë ku çdo ditë e më tepër po i kushtojmë rëndësi më të madhe edhe cilësisë së këtyre shërbimeve, ku vend shumë të rëndësishëm zënë aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare. Përmes shqyrtimit të ankesave, BQK-ja synon sigurimin e zbatimit të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale ndërmjet institucioneve financiare dhe klientëve, në rastet kur klientët konsiderojnë se një gjë e tillë nuk ka ndodhur", ka thënë ai.

Mehmeti ka shtuar se në vitet e fundit numri i klientëve të institucioneve financiare që parashtrojnë ankesë në BQK, lidhur me zbatimin e të drejtave të tyre kontraktuale, është rritur. "Ne konsiderojmë se rritja e numrit të ankesave në mënyrë të drejtpërdrejtë reflekton vetëdijesimin më të lartë të klientëve rreth të drejtës dhe mundësisë së tyre për ankesë, gjë e cila po i kontribuon mbrojtjes më të mirë të të drejtave të tyre, por edhe korrigjimit dhe avancimit të proceseve të brendshme në institucionet financiare për ofrimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të shërbimeve financiare, si dhe për evitimin e gabimeve të ndryshme. Ankesat e klientëve paraqesin një burim shumë të rëndësishëm informacioni edhe për BQK-në, e cila shpeshherë i merr ato në konsideratë gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse të institucioneve financiare", ka thënë guvernatori Mehmeti.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se, përveç aktiviteteve për adresimin e shkeljeve të mundshme nga institucionet financiare në raport me të drejtat e klientëve, BQK-ja po punon vazhdimisht për edukimin financiar të publikut, i cili ka për qëllim që të rritë sa më tepër shkallën e njohurive të publikut rreth produkteve financiare dhe të drejtave të tyre në raport me institucionet financiare. "Përveç aktiviteteve të saj në promovimin e edukimit financiar, BQK-ja në mënyrë të vazhdueshme inkurajon edhe institucionet financiare që ta rrisin aktivitetin e tyre në mbështetje të ngritjes së njohurive të publikut rreth produkteve financiare, sepse konsumatorët e mirinformuar ndërmarrin veprime të arsyeshme dhe kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e mëtejmë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar", ka thënë Mehmeti.

Po ashtu, guvernatori Mehmeti ka përmendur edhe kontributin e BQK-së për mbrojtjen e konsumatorit si anëtare e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, një trup ndërinstitucional që ka për qëllim të sigurojë një qasje të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Kosovë.

Ndërsa ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për organizimin e këtij diskutimi, duke shprehur gatishmërinë që të vazhdohet edhe më tutje bashkëpunimi mes dy institucioneve për mbrojtjen e konsumatorit. Në këtë diskutim është bërë prezantimi i mënyrës së shqyrtimit të ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në BQK dhe në institucionet financiare.

Hapet Panairi i Punës në Gjakovë

GJAKOVË, 15 MARS (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), me mbështetje të GIZ-it gjerman, kanë hapur të premten Panairin e Punës në Gjakovë.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, gjatë hapjes së panairit ka pohuar se ky panair do t'u shërbejë bizneseve që të takojnë punëtorë cilësorë dhe të kualifikuar, të cilët kanë shkathtësi dhe aftësi profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të bizneseve, si dhe punëkërkuesve potencialë për t'i prezantuar aftësitë e tyre profesionale dhe për t'u punësuar.

"Me qëllim të përmirësimit të punësueshmërisë në vend, ndër prioritet kryesore të MPMS-së është përkrahja e krijimit të vendeve të reja të punës qoftë në punësim të rregullt, nëpërmjet masave aktive të tregut të punës, por edhe për përgatitjen profesionale të fuqisë punëtore", ka thënë ministri Reçica.

Ministri ka thënë se nëpërmjet Panairit të Punës në Gjakovë shumë punëmarrësve, përkatësisht të rinjve, do t'u ofrohet mundësia të gjejnë një vend të qëndrueshëm pune, të angazhohen në praktikë në punë, por edhe të përfitojnë për të konkurruar në vende të ndryshme pune.

Mbahet punëtoria informuese për rrugën e qendrës historike të kryeqytetit

Prishtinë, 15 mars (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Fondacionin Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), ka mbajtur punëtorinë informuese me operatorët ekonomikë për projektin e rigjenerimit të rrugës "Model" në qendrën historike të kryeqytetit. Në këtë punëtori janë dhënë informata rreth projektit dhe harmonizimit të punëve që do të bëhen për realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për pjesën e vjetër të qytetit të Prishtinës. Rigjenerimi i rrugës "Model", si projekt, parasheh shtrimin e rrugicave me kalldrëm, futjen e kabllove elektrike nën tokë dhe rregullimin e fasadave sipas tipareve të arkitekturës origjinale të lagjes. Ky model më pas do të përdoret në rrugët e pjesët e tjera të qendrës historike.

Tetë shkolla të Drenasit përfitojnë projekte nga Zyra e BE-së për Arsim

Drenas, 15 mars (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit, ka fituar projektin "Përmirësimi i ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve" në nivelin arsimor 0 dhe 1, klasa përgatitore deri në klasën e pestë, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) për Arsim.

Në garë për përfitim të këtij projekti kanë qenë të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, kur prej tyre janë zgjedhur 10 komuna, ndër to edhe ajo e Drenasit. Përfituese janë tetë (8) shkollat e Komunës së Drenasit, të cilat do të jenë pjesë e implementimit të këtij projekti për mbështetjen e mësimdhënësve. Mësimdhënësit e nivelit të klasës përgatitore dhe fillore do të mbështeten me trajnime me bazë në shkollë, për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Shkollat përfituese të projektit në Drenas janë: ShFMU "Rasim Kiçina" në Drenas, ShFMU "Arif Shala" në Korroticë të Ulët, ShFMU "7 Marsi" në Kizhnarekë, ShFMU "Rilindja" në Dobroshec, ShFMU "Abedin Bujupi" në Arllat, ShFMU "Halil Bajraktari" në Drenasin II, ShFMU "Ali Gashi" në Çikatovë të Re dhe ShFMU "Shaban Polluzha" në Korroticë të Lartë.

Nxënësit e Kamenicës informohen rreth rreziqeve nga përdorimi i internetit

Kamenicë, 15 mars (ER) - Organizata Joqeveritare Network of Peace Movement (NOPM), bashkë me koordinatoren e Njësisë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NjKDNj), Nazmije Demolli-Kastrati, kanë mbajtur ligjëratë me temën "Si t'i mbrojmë fëmijët nga rreziqet e internetit", në Shkollën Fillore "Abdullah Krashnica" në Koretin, me nxënësit e klasave të VII, VIII dhe IX.

Qëllimi kryesor i kësaj ligjërate ka qenë t'i informojë nxënësit rreth rreziqeve që mund të hasin gjatë përdorimit të internetit dhe për parandalimin e këtyre rreziqeve. Forma e kësaj ligjërate kishte karakter informues dhe vetdijësues për rreziqet me të cilat ballafaqohen të rinjtë gjatë përdorimit të internetit dhe zbulimin e të dhënave të tyre nga sulmet e ndryshme kibernetike.

Koordinatorja Nazmije Demolli-Kastrati ka thënë se diskutimi me nxënës ka qenë interaktiv, ku janë marrë pyetje dhe përgjigje të ndryshme rreth mbrojtjes dhe vetëdijesimit të tyre. Ndërsa drejtoresha ekzekutive e NOPM-it, Besime Tusha-Maliqi, ka falënderuar nxënësit dhe drejtoreshën e kësaj shkolle, Merita Cocaj-Keqmezi, për bashkëpunimin e ndërsjellë.

Policia në Klinë ndalon shtatë mjete transportuese që bartnin dru pa dokumentacion

Pejë, 15 mars (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Pejë, Stacioni Policor në Klinë, më 14 mars, duke u bazuar në planin operativ "Marrja e masave ligjore kundër transportuesve ilegalë të masës së drurit", ka ndërmarrë një operacion policor në zonën e kësaj komune, me qëllim të mbrojtjes së pyjeve të cilat janë duke u prerë dhe transportuar në mënyrë ilegale nga persona të ndryshëm. Lidhur me këtë është njoftuar Inspektorati Komunal si dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari pranë Kuvendit Komunal Klinë dhe së bashku ka filluar zbatimi i planit. Gjatë zbatimit të këtij plani Policia e Kosovës në këtë zonë ka ndaluar shtatë mjete transportuese, të cilat kanë qenë duke transportuar masë drunore pa dokumentacion përkatës. Në bashkëpunim me inspektorët e tregut, me zyrtarët për bujqësi dhe pylltari, masa drunore është konfiskuar me urdhër të prokurorit të shtetit dhe ndaj të dyshuarve janë iniciuar rastet 'transport ilegal i druve' dhe janë ndërmarrë masat adekuate ligjore.

Homazh

EKREMI I PËRJETËSISË

Njeri i vlerave të sinqerta të dashurisë dhe të çiltërsisë

Prof. dr. Faik SHKODRA

Ekrem Shkodra unin dhe jetëshkrimin e vet e dëshmoi përmes dashurisë dhe ndjenjës shpirtërore që kishte për vendlindjen - Desivojcën, ku lindi dhe kaloi fëmijërinë me lojërat e këngët e ruajtura nga brezat e hershëm, me të cilët i forcoi lidhjet shpirtërore e kulturore. Me këto përpjekje e përjetime vendosi raporte të natyrshme me kohën e historinë e të parëve, me mitologjinë e vendlindjes, me magjinë e bukurive natyrore të Desivojcës, me botën e pasur shpirtërore të njerëzve të afërt dhe të largët, duke i respektuar vlerat morale dhe edukative, me të cilat duhet të jetë i pajisur njeriu, si: ndershmëria, fisnikëria, çiltërsia, bujaria, maturia, modestia, vendosmëria, respekti e dashuria.

Ekremi u bë një intelektual i urtësisë dhe i mençurisë, tamam siç e kërkojnë koha dhe traditat tona kombëtare. Në zemrën dhe shpirtin e Ekremit kanë shpërthyer vetëm fjalët e ëmbla dhe të ngrohta. Nga fëmijëria, në natyrën e virgjër të Desivojcës, ishte edukuar që të dashuronte njeriun, të vërtetën, të bukurën, dhe ndaj njeriut të përdorte gjuhën që shëron plagët, nëse ato ishin çelur te ky apo ai njeri.

Por, data e 4 shkurtit e vitit 2019 solli dhimbje të rënda për familjen e ngushtë Shkodra dhe për miqtë, dashamirët dhe për të gjithë ata që kishin pasur fatin e rastin të njiheshin me të. Në këtë ditë Ekremi e mbylli derën e jetës tragjikisht, duke u vetëmbytur në Liqenin e Livoçit. Ekremi vdiq dhe gruaja, djali dhe dy vajzat e tij, me fakultete të mbaruara, mbetën pa më të dashurin, ndërsa prindërit - nëna dhe babai, vëllezërit, motrat, nipat, mbesat, dhëndurët, hallat, kushërinjtë, miqtë e shokët dhe i tërë farefisi i ngushtë e i gjerë mbetën pa më të dashurin e tyre, që aq shumë i deshi dhe e deshën dhe e çmonin në lartësinë e njeriut me vlera, virtyte dhe tipare të veçanta. Me të drejtë thuhet se fatkeqësisë, momentit të lig e tragjik, askush nuk mund t'i ikë. Në çastet e krizave mendore e shpirtërore, njeriu do të ishte mirë që me fuqinë e shpirtit ta sfidojë atë çast të rëndë dhe të zgjedhë mundësinë e triumfit të pavarësisë dhe të dinjitetit të fuqishëm si njeri. Është thënë, po ashtu, se njeriu, për t'u çliruar nga frika e vdekjes, "vazhdimisht" duhet t'i çojë mendtë tek ajo, të pajtohet plotësisht me fundin tragjik të tij. S'është larg mendjes se pikërisht ky obsesion e urdhëron për vetëvrasje.

Ekremi ishte i veçantë, për shumëçka dhe për gjithçka. Duke qenë i tillë, ai vendosi t'u bashkohej njerëzve që dinë, ose së paku e ndiejnë se do të vdesin para kohe. Vdekja e parakohshme mbetet pa përgjigje, sepse edhe pyetjet: Si? Pse? dhe Qysh? për të ikur para kohe, në thelb, janë të panevojshme. Janë të tilla, sepse çdo njeri në vetvete ka një thembër të Akilit, që i shkakton dhimbje e mërzi. Njerëzit që kanë diçka nga thembra e Akilit, loti dhimbjen ua pi, ndërsa njeriun e dërgon në rrugë pa krye. Secili njeri i gjallë mbart diçka nga thembra e Akilit. Në çastin kur dhimbja bëhet e padurueshme, pikërisht atëherë ndodh akti i vetëvrasjes - vrasje që s'mund ta ndalë asnjë fuqi.

Në jetën e Ekremit ne të gjallët kemi parë njeriun e virtyteve, tipareve dhe vlerave të larta, vlera që vijnë si stoli e dhuratë hyjnore nga shpirti dhe sjelljet prej një njeriu që përfaqëson ndjenjat dhe edukatën më të lartë ndaj njerëzve. Personalitetin e Ekremit e shquanin shumë cilësi, që lidhen me kulturën e qëndrimin e qetë, me qëndrimin e dinjitetshëm. Falë tipareve e sjelljeve plot kulturë, nga ai numër aq i madh që morën pjesë në ceremoninë e varrimit e të ngushëllimeve, mori vlerësime, gjykime e mendime më të veçanta, mori respektin, mori fjalët më brilante, mori ngrohtësinë shpirtërore e ndjenjore të të gjithëve - si njeri, si prind, si vëlla, si qytetar dhe si burrë i vlerave dhe virtyteve të larta.

Ekremi la pas tre fëmijë, Elbasanin, emër simbolik, që t'i kujton tingujt e këngës nostalgjike, ekonomist i diplomuar; Doruntinën me telekomin të kryer; dhe Drenushën, ekonomiste të diplomuar - të tre i shquan formimi i drejtë e i shëndoshë edukativ dhe arsimor dhe të tre paraqesin krenari për emrin dhe punën e Ekremit. La bashkëshorten, një grua fisnike dhe ideale, si nënë, që mund të merret si model. La nënën dhe babanë, të njohur për vlera të larta njerëzore e humane. La vëllezërit e motrat, që njihen si të veçantë në aspektin e mirësjelljes, bamirësisë dhe humanizmit, si thesare më të larta, ndërsa vetë Ekremi la një emër dinjitoz, që mund të lakohet në të gjitha rasat. Ai sikur e kishte kuptuar se liria e shpirtit as nuk blihet as nuk shitet dhe se ndërgjegjja e pastër, sinqeriteti dhe ndershmëria janë vlerat më të jashtëzakonshme për çdo njeri të formuar me edukatë e kulturë të pasur.

Nga njerëzit e mençur është thënë se njeriu duhet të njohë ligjet e natyrës, të njohë çastin e lindjes e të vdekjes dhe se jeta është provë shenjtërie, për të kaluar në përjetësinë e botës së amshuar. Duke shkruar këtë nekrolog për Ekremin, kisha parasysh t'i paraqes vlerat e tiparet e tij vetëm objektivisht, vetëm sinqerisht, vetëm ashtu siç ishte, modest, i matur dhe i çiltër.

Ekrem Shkodra, me punën e vet, me djersë e aftësi personale, me qëndrim prej një njeriu shembullor, arriti të krijonte autoritetin e një njeriu me vlera të shumta, me vlera që rrezatojnë karakterin e tij. Duke i pasur parasysh cilësitë dhe virtytet e Ekremit, me plot gojën themi se edhe pas vdekjes nuk do të largohet nga kujtesa e të gjithë atyre njerëzve që e kanë njohur, por do të vazhdojnë të jetojnë kujtimi, nderimi, respekti dhe dashuria plot aromë ngrohtësie e malli të pashuar.

Sokrati me të drejtë është shprehur: "Gjithë shpirtrat e njerëzve janë të pavdekshëm, por shpirtrat e të drejtëve janë edhe të pavdekshëm edhe hyjnorë".

"Ashtu qoftë!" - do të thoshte Faik Konica.

MZhE-ja ndan 290 mijë euro për sektorin e arsimit në Gjakovë

GJAKOVË, 15 MARS (ER) - Në vazhdën e implementimit të projektit "Promovimi i efiçiencës së energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të efiçiencës së energjisë", Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit me Komunën e Gjakovës.

Ky memorandum i bashkëpunimi kap shifrën totale prej 319 mijë eurosh, ku 290 mijë sosh do të ndahen nga MZhE-ja dhe 29 mijë nga Komuna e Gjakovës për restaurimin e Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Ylli Morina" në Gjakovë, duke e bërë atë më efiçiente nën kornizën e zbatimit të planit të zbatimit të masave efiçiente.

Ministri Lluka gjatë fjalimit ka thënë se ky nuk do të jetë donacioni i vetëm që do të bëhet në shkollat e qytetit të Gjakovës. "Ky investim prej 290 mijë eurosh nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është pjesë e zbatimit të masave të efiçiencës së energjisë në nivel lokal. Me anë të këtij fondi do ta restaurojmë shkollën 'Ylli Morina' duke e bërë atë më efiçiente. Ky donacion nuk do të jetë i fundit, ashtu siç kemi investuar më herët për krijimin e laboratorit të informatikës në shkollë. Ne do të vazhdojmë investimet në fushën e teknologjisë, duke krijuar qendrën kreative dhe investime të ngjashme do të ndodhin në shkollat e tjera të qytetit të Gjakovës", ka thënë ministri Lluka.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se është shumë falënderues për shumën e ndarë për restaurimin e shkollës.

Koreja e Veriut refuzon kërkesat e ShBA-së për çnuklearizim

Penian, 15 mars - Koreja e Veriut thotë se Peniani nuk ka ndërmend t'u bëjë lëshime kërkesave të Uashingtonit dhe se Kim Jong Un do të dalë së shpejti me një deklaratë mbi mundësinë e bisedimeve të mëtejshme. Njoftimet thonë se Kim Jong Uni mund të rishikojë vendimin që i jep fund provave me raketa për më shumë se një vit.

Sipas një njoftimi të agjencisë së lajmeve "Associated Press", zëvendësministri i Jashtëm Choe Son Hui, i cili i informoi gazetarët dhe diplomatët në Penian të premten, tha se Uashingtoni humbi një mundësi të artë në samitin e dytë të mbajtur në Hanoi në fund të shkurtit me presidentin amerikan Donald Trump, ku palët nuk mundën të arrijnë një marrëveshje.

Presidenti Trump tha se ai u largua nga tryeza e bisedimeve për shkak të qëndrimeve të ndryshme rreth asaj se çfarë duhet t'i kërkohej Koresë së Veriut që asaj t'i lehtësoheshin sanksionet.

Beto O'Rourke shpreson të sjellë energji te demokratët

Ligjvënësi O'Rourke ishte pak i njohur në shkallë vendi përpara se të garonte kundër senatorit republikan Ted Cruz nëntorin e kaluar, një garë që e humbi me rezultat të ngushtë. Tani ai shpreson të shfrytëzojë këtë rritje të shpejtë të popullaritetit për t'u bërë president i vendit në vitin 2020

Uashington, 15 mars - Ish-ligjvënësi nga Teksasi, Beto O'Rourke, është një tjetër politikan që hynë në garë për ta marrë emërimin e Partisë Demokratike si kandidat i saj për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020. Në këtë garë tashmë ka një numër të madh dhe të larmishëm kandidatësh. Ligjvënësi O'Rourke ishte pak i njohur në shkallë vendi përpara se të garonte kundër senatorit republikan Ted Cruz nëntorin e kaluar, një garë që e humbi me rezultat të ngushtë. Tani ai shpreson të shfrytëzojë këtë rritje të shpejtë të popullaritetit për t'u bërë president i vendit në vitin 2020. "Po hyj në garë për t'ju shërbyer si president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës! Faleminderit", tha Beto O'Rourke, kandidat për president.

Pas disa muajsh pritjeje, ish-ligjvënësi nga Teksasi, Beto O'Rourke nisi fushatën e tij presidenciale në shtetin e Ajovës, një nga shtetet e para që mban zgjedhjet paraprake, me një video në internet. "Ne vërtet jemi shpresa e fundit e madhe e botës. Në këtë moment të rrezikut maksimal dhe të potencialit maksimal, le t'i tregojmë vetes dhe atyre që do të na pasojnë në këtë vend të madh se kush jemi dhe çfarë mund të bëjmë", tha ai.

Në moshën 46-vjeçare, O'Rourke sjell një energji të re dhe aftësi të veçantë të mbledhjes së fondeve në një garë të mbushur me kandidatë dhe të larmishme presidenciale të demokratëve.

Ish-ligjvënësi O'Rourke tërhoqi vëmendjen kombëtare vitin e kaluar pasi ai gati mposhti senatorin republikan të Teksasit, në një fushatë që frymëzoi demokratët përtej kufijve të këtij shteti konservator. "Ne nuk do të përkufizohemi nga ato që kundërshtojmë, ose nga gjërat nga të cilat jemi të frikësuar", tha ai.

Në Shtëpinë e Bardhë, presidenti Donald Trump tha se është i gatshëm të garojë kundër çdo kandidati demokrat vitin e ardhshëm, pavarësisht nëse është O'Rourke apo dikush tjetër. "Unë kurrë nuk kam parë kaq shumë lëvizje të duarve. Thashë me vete: "A është i çmendur apo kjo është mënyra tij e zakonshme?" Mendoj se do të jetë e vështirë për këdo. Kushdo që të jetë, për mua nuk ka rëndësi", tha ai.

O'Rourke i bashkohet një grupi të larmishëm kandidatësh, që pasqyron një gamë të gjerë pikëpamjesh politike, nga ato të qendrës deri tek ato ultra-liberale, thotë analisti John Hudak. "Mendoj se do të shohim një debat energjik të ideve dhe çështjeve që nuk e pamë aq shumë në vitin 2016 dhe që me siguri nuk do ta shohim në anën e republikanëve", thotë John Hudak, i Institutit Brookings.

O'Rourke mbështet idenë e kujdesit shëndetësor për të gjithë, mbrojtjen e emigrantëve dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ai gjithashtu sjell pasion në garë, por do të përballet me kandidatë të njohur, të cilët janë po aq energjikë, si senatorja demokrate nga shteti Masaçusets, Elizabeth Warren. "Kur një qeveri punon shumë për ata që kanë para dhe pushtet dhe jo për pjesën tjetër të popullit, kjo është thjesht korrupsion, dhe duhet ta quajmë ashtu siç është", tha ai.

Ish-nënpresidenti Joe Biden tha se së shpejti do t'i bashkohet garës për president dhe shpejt mund të bëhet kryesues i saj.

Por disa demokratë mund të kërkojnë një kandidat jashtë klasës së njohur politike për t'iu kundërvënë presidentit Trump vitin e ardhshëm, thotë Will Marshall nga Instituti i Politikave Progresive. "Njerëzit nuk po kërkojnë përvojë nga Uashingtoni tek presidenti i tyre. Ata duan të sfidojnë një kulturë politike, një klasë politike që ata mendojnë se është jofunksionale", tha Marshall.

O'Rourke do t'i bëjë disa ndalesa në turneun e tij në Ajova dhe më pas do të mbajë një tubim të madh fushate në qytetin e tij të El Pasos, në Teksas, më 30 mars.

Guaido thotë se Rusia dhe Kina nuk mbështesin Maduron

Karakas, 15 mars - Udhëheqësi i opozitës në Venezuelë u tha mbështetësve të tij të enjten në kryeqytetin Karakas se Rusia dhe Kina nuk po e mbështesin presidentin Nicolas Maduro. Presidenti i përkohshëm i vetëshpallur Juan Guaido tha se ato dy vende thjeshtë po ndjekin interesat e tyre të biznesit në Venezuelë.

Edhe pse shumica e vendeve perëndimore, përfshi Shtetet e Bashkuara, e kanë njohur Guaidon si president legjitim të Venezuelës, Rusia dhe Kina kanë shprehur mbështetje për Maduron. "Ata janë të izoluar dhe nuk mund t'i zgjidhin problemet që kanë krijuar. Ata nuk kanë asnjë aleat ndërkombëtar. Nuk është e vërtetë se Rusia dhe Kina i mbështesin, është gënjeshtër e madhe. Askush nuk i mbështet. Rusia dhe Kina janë shumë të qarta se ku qëndron interesi i tyre dhe është i vlefshëm, e kuptoj shumë mirë. Ajo që ata duhet të kuptojnë, sikurse bëjnë të gjitha vendet, se e vetmja gjë që mbron qytetarët është zbatimi i ligjit", tha presidenti i përkohshëm i vetëshpallur Juan Guaido.

Pretendimi i Guaidos mund të mbështetet nga Venezuela e pasur me naftë e cila merr miliarda nga Kina si rezultat i marrëveshjeve të shkëmbimit të naftës për kredi si dhe nënshkrimit nga Rusia të marrëveshjeve të përbashkëta miliarda dollarësh për prodhimin e naftës. Por, nga ana tjetër,

Maduro po refuzon të heqë dorë nga pushteti pavarësisht mungesës së ushqimeve, ujit dhe energjisë elektrike. Ai ka thënë se është viktimë e një grusht shteti nga ShBA-ja.

Hulumtim për rëndësinë e remitencave dhe mundësitë për të ardhmen në Kosovë

Naim Gashi, magjistër i shkencave ekonomike

Remitencat

Remitencat në mbarë botën llogariten të jenë fluksi i dytë financiar më i rëndësishëm pas ndihmave ndërkombëtare. Remitencat në kuptimin e gjerë të fjalës janë transferta monetare që emigrantët kryejnë në vendin e origjinës. Natyra, madhësia, frekuenca, impakti dhe faktorët që ndikojnë në vlerat e tyre kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe politikëbërësve. Interesi i madh që është shfaqur ndaj remitencave në kohë të fundit i dedikohet kryesisht faktit se stabiliteti i tyre po i shndërron ato në një instrument tepër të lakmuar për të nxitur më tej zhvillimin financiar dhe ekonomik në vendet në zhvillim. Bazuar në studimet e kësaj fushe, rezulton se remitencat kanë një rëndësi tejet të madhe. Kosova ka një nga normat më të larta të migrimit në Evropë, për të parë pse niveli i migrimit tek qytetarët e Kosovës është kaq i lartë, dhe duhet analizuar faktorët të cilët kanë shtyrë të marrin rrugën e migrimit, kur analizojmë faktorët kemi dy periudha të migrimit: periudhën nga vitet e '60-ta kur edhe ka filluar migrimi nga Kosova deri në vitin 1999. Gjatë kësaj periudhe arsyet kryesore të migrimit ishin kryesisht lufta, gjendja e rëndë ekonomike dhe situata e tensionuar politike në vend. Me të përfunduar lufta u mendua se trendi i migrimit do të shkojë në rënie por ndodhi e kundërta, migrimi vazhdoj edhe me tutje duke marrë përmasa në rritje. Në këtë drejtim ia vlen për ta përmendur valën e fundit të migrimit nga Kosova vitet 2014-2015. Këto vite shënojnë një periudhë të eksodit ku Bashkimi Evropian përjetoj një rritje të shpejtë të numrit të qytetarëve të Kosovës.

Sipas disa të dhënave mendohet se gjatë kësaj periudhe nga vendi u larguan drejt vendeve evropiane 50,000 persona, sipas disa të dhënave të tjera mendohet se ky numër ishte 100,000 persona.

Arsyet kryesore pse shumë të rinj të Kosovës e shohin migrimin si zgjidhjen më të mirë për të ardhmen janë: papunësia, gjendja e rëndë ekonomike, korrupsioni, mossundimi i ligjit, nepotizmi etj. Shumë të rinj e shohin migrimin si mundësi për një të ardhme më të mirë dhe sigurimin e një pune për të siguruar ekzistencën. Rreth 65 për qind e të rinjve në Kosovë planifikojnë të migrojnë në dy vitet e ardhshme.

Në bazë të studimeve që janë bërë deri më tani, llogaritet të jenë rreth 700,000 persona që jetojnë diku në mërgim apo thënë ndryshe çdo e katërta familje ka të paktën një person në mërgim. Diaspora e Kosovës me remitencat e tyre ka ndihmuar Kosovën në kohët më të vështira kur ka kaluar vendi gjatë viteve '90-ta dhe sidomos gjatë viteve '98-'99 duke e mbajtur gjallë jetesën në çdo sferë të jetës, duke dërguar shuma të mëdha parash në vend. Nga tabela shohim se mërgata e Kosovës është shumë e lidhur me vendin e origjinës duke i qëndruar kohës dhe distancës. Trendi i dërgimit të remitencave në vend ka qenë në vazhdimësi në rritje në përjashtim të viteve 2009, 2010 dhe 2011 për shkak të krizës globale financiare.

Trendi pozitiv që ka qenë deri më tash nuk garanton se do të jetë edhe në të ardhmen për arsye se shumë mërgimtar tashmë janë stabilizuar në vendet ku jetojnë duke i marrë me vete edhe anëtarët më të ngushtë të familjes. Shumë mërgimtarë ndihen të zhgënjyer, të ofenduar dhe të lënë pas dore nga institucionet vendore, për shkak se pas përfundimit të luftës në vend, nuk është bërë asgjë konkrete lidhur me diasporën duke mos i dhënë vendin e merituar dhe trajtimin e duhur që ata e meritojnë për kontributin e madh të dhënë ndër vite.

Është koha e fundit që institucionet vendore të bëjnë hapa konkret lidhur me diasporën që lidhja Kosovë-diasporë, të jetë sa më e fortë në të ardhmen për shkak të potencialit të madh që ka diaspora, dhe kjo do ishte me përfitime të dyanshme.

Gjatë hulumtimit për remitencat si rast konkret kam trajtuar tri vende: Armeninë, Irlandën dhe Izraelin.

Armenia është një vend tjetër pa diasporën, dhe komplet një vend tjetër me diasporën. Diaspora është përparësia, pasuria e jonë e cila duhet përdorur për të forcuar atdheun e tyre. Ne duhet bërë çmos për të bashkuar diasporën me atdheun tonë. "Sa më e fortë të jetë Armenia aq më e fortë dhe krenare do të jetë diaspora", kështu ka thënë presidenti i Armenisë, Serzh Sargysyan.

Diaspora armene dhe emigrantët e rinj luajtën rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në përformancen ekonomike në periudhë post-sovjetike te Republika e Armenisë pas rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991. Transferet private nga diaspora kryesisht nga emigrantët e rinj u bënë injeksione të përkohshme për të lehtësuar barrën e tranzicionit të Armenisë në vitet 1993-1994, vitet e mungesës së madhe të energjisë elektrike, konfliktet me Azerbejxhanin mbi Nagorin Karabag dhe bllokimi i transportit nga Turqia dhe Azerbejxhani.

Të tria vendet kanë shumë të përbashkëta në trajtimin e diasporës duke e rregulluar me ligj statusin e tyre duke e konsideruar si një kapital shumë të çmuar për vendin, si dhe duke ju ofruar lehtësira të ndryshme për investitorët potencial nga diaspora: si lehtësira tatimore, fiskale, doganore po ashtu ofrimin e ndihmave të ndryshme dhe përkrahje në mënyrë institucionale. Këto kanë bërë që shumë investitorë nga diaspora të investojnë shuma të mëdha në vendet e tyre duke ndikuar direkt në zhvillimin ekonomik në vend.

Falë investimeve nga diaspora Irlanda pas viteve te '70-ta ka përjetuar një rritje shumë të shpejt ekonomike duke e bërë një nga vendet më të zhvilluara jo vetëm në Evropë por edhe në botë.

Këto tri vend janë një model shumë i mirë edhe për vendin tonë se si duhet trajtuar diaspora nga institucionet vendore.

Rekomandimet

Rekomandimi kryesor i këtij hulumtimi është që fokusi i interesit të drejtohet në përmirësimin e kushteve për të bërë biznes si dhe zbatimin e ligjit që investitorët potencial nga diaspora ta kenë më të lehtë që kursimet e tyre t'i investojnë në Kosovë. Për shkak të lidhjes emocionale me vendin e origjinës që kanë me Kosovën shumë mërgimtarë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të investuar në vend, por për shkak të pasigurisë në kushtet e të bërit biznes, ky numër është shumë i vogël. Nga totali i shumës së përgjithshme e të hyrave nga remitencat pjesa më e madhe apo thënë një përqindje rreth 60 për qind e tyre shkon për konsum direkt dhe vetëm 3 për qind shkon për investime në biznes.

Krijimi i kushteve më të volitshme për të bërë biznes: zbatimin e ligjit, uljen e korrupsionit dhe ofrimin e lehtësirave të ndryshme për investitorët potencial do të ndikonte direkt në uljen e papunësisë, rritjen e prodhimtarisë në vend deri tek rritja e zhvillimit ekonomik. Prandaj është me shumë rëndësi që diaspora të trajtohet me kujdes të veçantë nga institucionet vendore.

Hulumtimi është bërë duke u bazuar në të dhënat aktuale të publikuara nga: BQK-ja, ASK-ja, ATK-ja, Banka Botërore etj.

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Remitencat	588.5	608.7	585.7	584.3	492.5	516.4	573.4	622.3	665.5	691.0	759.2	662.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2018

Të dhënat për vitin 2018 janë të përfshirë muajt nga Janari-Tetori

E rrallë

Peshkaqeni 'puth' zhytësin



Zhytësi Kevin Schmid po kryente një ekspeditë në bregdetin e Cape Town, në Afrikën e Jugut, kur papritur u gjend ballë për ballë me një peshkaqen blu. Krijesa iu afrua shkencëtarit dhe i 'përkëdheli' me turinj maskën që ai mbante. Gjesti, aspak agresiv, mund të duket edhe si një lloj puthjeje. Më pas peshkaqeni u largua, duke lënë të habitur zhytësin, i cili, pas disa sekondash hutim, rinisi aktivitetin.

FOTO E DITES

Një teknik shihet duke punuar në një turbinë me erë në një kodër në Izmir në bregun perëndimor të Anadollit. / Foto: Anadolu Agency

E jashtëzakonshme

Vdes pas operacionit të transplantimit të flokëve

Një biznesmen indian ka vdekur pas një reaksioni alergjik gjatë transplantimit të flokëve. Shrawan Kumar Choudhary iu nënshtrua operacionit në një klinikë private në Mumbai, sipas medieve lokale. 43-vjeçari, i cili drejtonte një firmë logjistike, vdiq një ditë pas operacionit 12 orësh.

BARSOLETA E DITËS

Vajza: Petrit, jam çmendur pas teje!
Djali: Mirë, mirë, por rri larg babait tim.
Vajza: Pse, është i ashpër me vajzat që vijnë rrotull?
Djali: Jo, por është drejtor i Spitalit Psikiatrik.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Nëse përgjatë një kohe të caktuar keni qenë në krizë, sot do të ndryshojë gjithçka. Do të vëreni përmirësime në të gjitha fushat e jetës.

DEMI
Mos merrni përsipër gjëra të reja apo iniciativa financiare nëse nuk jeni të sigurt që keni mbyllur punët dhe projektet e nisura më parë.

BINJAKËT
Është një moment i përshtatshëm për investime dhe nëse bëni një hap tani, do të përfitoni shumë në të ardhmen tuaj. Sa iu përket ndjenjave, keni të reja.

GAFORRJA
Ditë mjaft entuziaste dhe me mjaft optimizëm. Ndiheni të gjallë dhe të gatshëm të merrni përsipër projekte të reja.

LUANI
Do të gjendeni duke zgjidhur keqkuptimet midis miqve ose kolegëve që nuk i keni shkaktuar ju. Por, kudo nevojitet një amortizator për t'i ulur tonet.

VIRGJËRESHA
Emocione të bukura për këdo nga ju që ka nisur një punë të re ose është zhvendosur në një vend të ri. E panjohura po ju tërheq.

PESHORJA
Sot nëse bini pre e provokimeve do të keni mjaft debate që nuk do t'ju çojnë askund. Mbase po të tregoheni më të matur do t'ia dilni të mos përfshiheni.



AKREPI
Po tërhiqni pas vetes një problem prej kohësh dhe nuk po arrini dot ta zgjidhni. Kërkoni mendime diku ku keni besim se mund t'ju ndihmojnë.



SHIGJETARI
Sot fati është në anën tuaj. Diçka që e ëndërroni prej kohësh sot do të bëhet realitet dhe ju do të ndiheni mjaft të realizuar.

BRICJAPI
Kujdes me shpenzimet sot sepse duhet të reduktoheni të merrni vetëm gjëra të nevojshme. Tregohuni më të matur në financa.

UJORI
Tregohuni shumë të kujdesshëm me letrat sot. Lexoni shumë mirë gjithçka që do t'ju duhet të firmosni sepse mund të keni pasoja.



PESHQIT
Mos u irritoni nga persona që mendojnë gjithmonë si t'ju vënë në vështirësi. Bëni mirë të mos i konsideroni fare kushdo që të jetë arsyeja.

Drake fiton një çmim të rëndësishëm



Këngëtari amerikan Drake ka fituar çmimin "Artisti i vitit" në Heart Radio Music Awards. Në këtë kategori të nominuar ishin edhe Ed Sheeran, Kendrick Lamar, Post Malone dhe Shawn Mendes.

David Guetta, i lumtur në krahët e të dashurës 24 vjet më të re

DJ me famë botërore, David Guetta, po shijon jetën në Miami. 51-vjeçari nuk mund t'i heqë duart nga e dashura e tij Jessica Ledon, me të cilën ka shkuar për pushime në plazh. Çifti është fotografuar duke shkëmbyer puthje dhe përqafime jashtë hotelit të tyre me pesë yje në Miami.

Jessie J dhe Channing Tatum, të lumtur pranë njëri-tjetrit

Romanca e tyre e befasishme u bë publike në muajin tetor të vitit të kaluar. Këngëtarja 30-vjeçare Jessie J dukej shumë e lumtur pranë të dashurit të saj, 38-vjeçarit Channing Tatum. Ata janë fotografuar nga paparacët në aeroportin "Heathrow" në Londër. Këngëtarja britanike ishte shumë e buzëqeshur derisa po ecte pranë Tatumit, me të cilin ishte parë më herët në publik edhe në Los Angeles derisa po tërhiqnin valixhet e tyre.

Jussie Smollett deklarohet i pafajshëm

Jussie Smollett, aktori i "Empire", i akuzuar nga policia e Çikagos për inskenim të një krimi të urrejtjes për përfitim personal, u deklarua i pafajshëm të enjten. Ndaj tij rëndojnë akuza për 16 vepra penale, të cilat aktori i mohoi. Data tjetër e gjykimit e Smollettit ishte caktuar për 17 prill. Ekipi ligjor i aktorit ka deklaruar të martën se ata donin kamera në sallën e gjyqit, kështu që publiku mund t'i shihte provat.

10 gjëra që nuk i dini rreth filmit "300 Spartanët"

Më 9 mars 2007, filmi kult në Betejën e Termopileve ndërmjet grekëve dhe persëve arrin në kinematë amerikane, duke e shndërruar Gerard Butlerin gjysmë të panjohur në një yll të Hollivudit

Më 9 mars 2007, doli në SHBA "300" Zack Snyder, një adaptim filmi i romanit grafik poemë nga Frank Miller. Filmi, i xhiruar me teknologjinë digjitale "chroma key" për të riprodhuar stilin e stripit origjinal, tregon betejën e Termopileve mes Spartans dhe Persianëve në 480 para erës sonë.
Me gjithë pabarazinë numerike të pabesueshme, 300 ushtarët e guximshëm të udhëhequr nga Mbreti Leonidas, interpretuar nga Gerard Butler, atëherë gjysmë i panjohur, arrijnë të mbajnë armiqtë aziatikë

në kontroll në fytin e ngushtë të Termopileve dhe, duke iu rezistuar heroikisht, lejojnë ushtrinë greke të riorganizohet.
Megjithëse kolosalët kanë tërhequr kaq shumë kritika si për të metat narrative (nga njëra anë ka të mirat dhe nga ana tjetër barbarët e keqe, monstruoze, të pamëshirshme dhe epshore) se për gabimet e shumta historike dhe për akuzat e racizmit (Iran të udhëhequr nga Presidenti Ahmadinejad, ai thotë se me këtë film "Hollyëood shpalli luftë në Teheran", suksesi i zyrave të biletave është i pabesueshëm.
Duke kushtuar 65 milionë dollarë, filmi mbledh 456 dhe e transformon protagonistin Gerard Butler në një yll të Hollivudit. 12 vjet më vonë, ja 10 gjëra që ndoshta nuk i keni njohur rreth filmit.

Kostume të ricikluara dhe armë

Për të përmbajtur buxhetin, prodhimi riciklon armë (mburoja, shpata dhe shtiza) të përdorura tashmë në epikën e filmave të tjerë në Greqinë e lashtë të dekadës së fundit si "Troja" dhe "Aleksandër". Përkundër kësaj, më shumë se 60 njerëz punojnë për të riprodhuar kostumet e kohës dhe së paku 600 janë ato të bëra posaçërisht për filmin. Protagonisti Gerard Butler mban 17 helmeta, ndërkohë që Rodrigo Santoro, përkthyesi i mbretit persian, Serse, mban 33 pirsing të rreme.

Stërvitje të forta

Shumica e aktorëve të filmit kanë një trup fizik muskulor, rezultat i punës së madhe në palestër. Për shembull, Gerard Butler është trajnuar 4 orë çdo ditë, si gjatë xhirimeve ashtu edhe në 4 muajt që kanë paraprirë marrjen e parë.

Emri i mbretëreshës dhe shuplaka në skenë

Gjatë gjithë filmit, gruaja e Leonidës e luajtur nga Lena Headey nuk thirret kurrë me emër, por gjithmonë me pseudonimin "mbretëreshë". Vetëm në titujt e fundit shfaqet emri i vërtetë "Gorgo". Në një skenë mbretëresha godet një nga këshilltarët e mbretit, pasi kjo e fundit e fyen atë. Para se të filmojë skenën, aktorja Lena Headey teston vrasjen e regjisorit Zack Snyder për të siguruar që ai nuk godet shumë.

Roli i mbretëreshës

Në fillim drejtori për rolin e Mbretëreshës Gorgo mendon për aktoren angleze Sienna Miller. Vetëm më vonë ai zgjodhi Lena Headey, i cili në sajë të kritikave të shkëlqyera u bë yll i Hollivudit. Që nga viti 2011 aktorja ka luajtur Mbretëresha Cersei Lannister në serialin e hitit "Il trono di Spade".

Fjalët e mbretëreshës

Në fillim të filmit, Mbretëresha Gorgo i përgjigjet ambasadorit persian, i cili me shumë nevoja pyet se si një grua reagon në intervistat midis burrave, me fraza të famshme: "Sepse vetëm gratë spartane lindin burra të vërtetë". Në realitet – historianët rindërtojnë – mbretëresha tregon këtë frazë për një grua athinase gjatë një interviste. Një frazë e Gorgo e përdorur në film është "Kthehuni me mburojën tuaj". Gratë spartane u thoshin këto fjalë burrave dhe fëmijëve të tyre kur ndaheshin para betejës.

Regjistroni regjistrimet në mënyrë kronologjike

Filmi "300" u xhirua për vetëm 60 ditë, një rekord duke marrë parasysh shumë ekstra dhe skenat e luftës. Kolosale të ngjashme zgjatën shumë (madje edhe vite të përpunimit). Një tjetër kuriozitet është se skenat janë xhiruar në mënyrë kronologjike ose siç shfaqen në versionin përfundimtar. Gjë që është jashtëzakonisht e rrallë për një film me metrazh të gjatë: skenat e filmave zakonisht filmohen duke marrë parasysh lokacionet, me qëllim të reduktimit të kostove dhe thjeshtimit të procesit të rimëkëmbjes.

Debutimi i yllit të ardhshëm

Mes 300 ushtarëve spartanë ka një yll të ardhshëm të Hollivudit që bën debutimin e tij të filmit. Ai është një i ri Michael Fassbender, në filmin e tij të parë. Irlandezi luan Stelios, ushtar spartan i cili bie në betejë pak para sovranit të Spartës dhe thotë: "Mbreti im … është një nder … të vdesësh nga ana jote". Leonidas përgjigjet: "Është një nder … të keni jetuar tuajën".

Djali i regjisorit

Djali i Leonidas luhet nga Eli, i cili nga ana e tij është biri i regjisorit Zack Snyder. Më vonë djali gjithashtu luajti në dy filma të tjerë të babait të tij, "Watchmen" dhe "Sucker Punch".

Pjesë të përmbysura

Aktori Rodrigo Santoro shfaqet për audicionin e personazhit të Astinos, birit të kapitenit Artemis. Megjithatë, regjisori vlerëson punën e tij aq shumë saqë ai e kërkon atë të luajë të keqin Serse.

Dëshira që është një fyerje

Në skenat finale Leonidas i thotë Efialte, "mund të jetosh përgjithmonë". Fraza, në vend se një dëshirë, është një fyerje: sunduesi aludon për faktin se tradhtari kurrë nuk do të ketë një vdekje të lavdishme në fushën e betejës, objektivi kryesor i çdo luftuesi spartan. Që atëherë në kulturën helenike "Efialte" bëhet arketipi i tradhtarit dhe e njëjta fjalë në greqishten e lashtë nënkupton "makth".

Brenda martesës së dytë të Michael Jackson dhe si i 'rrëmbeu' fëmijët e tij

Michael Jackson dhe Lisa Marie Presley, e cilësuar si martesa më e shkurtër në botën e showbiz-it, ishte shume intriguese. Gjatë udhëtimit të tyre të dytë u vunë re edhe problemet që çifti pati. Mbreti i Popit së pari lidhi miqësi me infermieren bionde Debbie Rowe, të cilën e njohu në zyrën e mjekut ku punonte.

"Ai dhe Lisa Marie ishin shkatërruar dhe unë po përpiqesha ta ngushëlloja sepse ishte vërtet i mërzitur", tha më vonë Debbie për miqësinë e tyre të hershme. Tre muaj pasi Michael dhe Lisa Marie u divorcuan, ai dhe Debbie dolën së bashku në publik, të veshur që të dy me të zeza dhe me vete kishin një djalë 8-vjeçar.

Në kohën e ceremonisë, Debbie ishte shtatzënë me fëmijën e parë që ajo i 'dhuroi' Michael. Lisa Marie kishte thënë më herët se ata nuk patën fëmijë sepse këngëtari ishte i papjekur për të rritur një fëmijë. Por në një intervistë në vitin 2003, Debbie përshkroi një tjetër anë të karakter të yllit të popit.

"Ai më tha se donte vërtetë që të ishte baba. Unë i thashë se mund të bëhej. Më shikoi më mëdyshje dhe unë sërish iu shprehe:-'Më lejoni që t'ua plotësoj këtë kërkesë. Ju lutem, me lejoni që ta bëj këtë! Duhet të jesh baba!'", rrëfeu infermierja.

Kur u pyet për atësinë nga Martin Bashir në "Living With Michael Jackson", këngëtari konfirmoi se Debbie kishte fëmijë me të 'si një dhuratë'. Vetëm pak muaj pas martesës së Debbiet dhe Michael, Princi Michael erdhi në jetë në shkurt të 1997.

Duke kujtuar ditën e lindjes së tij, Debbie tha:- "Michael ishte patjetër më shumë i emocionuar se unë. Ai ishte shumë i emocionuar. Pamja në fytyrën e tij … nuk e kisha parë kurrë atë të lumtur. Kjo e bëri atë të mrekullueshme për mua, për të parë lumturinë në fytyrën e tij", tha ajo.

Iu deshën gjashtë javë para se Debbie të shihte djalin e saj përsëri. Michael e mori djalin e vogël në fermën e tij Neverland, ku mori një ekip të përkushtuar dadosh, ndërsa Debbie shkoi për të qëndruar me një mik. 14 muaj më vonë, Debbie dhe Michael mirëpritën fëmijën e tyre të dytë një vajzë , të quajtur Paris.

Michael pranoi te Martin Bashir se ai e kishte 'rrëmbyer' vajzën e tij të vogël nga spitali pasi erdhi në jetë. "E kam rrëmbyer dhe kam shkuar në shtëpi me gjithë placentën dhe gjithçka rreth saj", pranoi ai. Vetëm 18 muaj pas lindjes së Parisit, Michael dhe Debbie u divorcuan.

Në fjalët e saja Debbie, e përshkroi marrëdhënien e saj me fëmijët si të largët dhe hoqi dorë nga të drejtat e kujdestarisë. Michael pas ndarjes – mori një banesë prej 8 milion dollarë si dhe një shtëpi në Beverly Hills.

Ajo shpjegoi: -"Kemi një marrëdhënie familjare dhe unë gjithmonë do të jem atje për të dhe për fëmijët e mi. Njerëzit më bëjnë vërejtje ku thonë se nuk mund ta besojnë që i braktisa fëmijët. Unë i lashë fëmijët e mi tek babai i tyre. Ata janë aty ku duhet të jenë. Fëmijët e mi nuk më quajnë mami, sepse unë nuk e dua këtë gjë. Ata janë fëmijët e Michael. Nuk po them se ata nuk janë fëmijët e mi, por i linda sepse doja që ai të ishte baba. Ka njerëz që duhet të jenë prindër dhe ai është një prej tyre. Unë mund të bëja diçka për të dhe kjo ishte ajo që munda të bëja ".

Ndërkohë që Princi dhe Paris mbetën në kujdesin e Michael, Debbie këmbënguli që ajo të kishte disa të drejta në edukimin e tyre – përfshirë vendimin e debatueshëm për të mbuluar fytyrat e tyre në publik.

"Kjo ishte kërkesa ime, jo e tij. Ai është shumë krenar për fëmijët e tij. Jam tmerruar kur lexova disa shënime që dikush donte të rrëmbente fëmijët e tij", tha ajo.

